



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:001153

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05731420

Ac.nr.6569/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: I.B. B. nga fsh. R. Komuna Ferizaj, B. B. nga H. i E., G. B.K. nga Sh., A. Z. nga fsh P., M. D. nga fsh. B. K. Lipjan, H. S. nga Ferizaj, që të gjithë me autorizim i përfaqëson A. H. avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Agjencia për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatia Shtetërore nga Prishtina, objekti i kontestit kompensim i shpenzimeve të ushqimit nga marrëdhënia e punës, si dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.36/20, datë 07.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Agjencia për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.36/20, datë 07.07.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.36/20, datë 07.07.2021, ka vendosur si në vijim: I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve: I.B. B. nga fsh. R. Komuna Ferizaj, B. B. nga H. i E., G. B.-K. nga Sh., A. Z. nga fsh. P., M. D. nga fsh. B. Komuna Lipjan, H. S. nga Ferizaj, si e bazuar. II.DETYROHET e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Agjencia për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur

me seli në Prishtinë Komuna, që paditësve: 1. B. B. nga fsh R. Komuna Ferizaj, B. B. nga H. i E., G. B.-K. nga Sh., A. Z. nga fsh.P., M. D. nga fsh B. Komuna Lipjan, H. S. nga Ferizaj, në emër të shpenzimeve të ushqimit nga marrëdhënia e punës, udhëtimit, si dhe shpërblimit jubilar, t'ua paguaj shumat si në vijim: 1. Paditësen B. B. në emër të shpenzimeve të ushqimit për 699 ditë pune shumën prej 1,398.00 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 669 ditë pune shumen prej 489.30 €, gjithsejtë shumen prej 1,887.30 €. 2. Paditëses B. B. në emër të shpenzimeve të ushqimit për 699 ditë pune shumën prej 1,398.00 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 669 ditë pune shumen prej 978.60 €, gjithsejtë shumen prej 2,376.60 €. 3. Paditëses G.B.K. në emër të shpenzimeve të ushqimit për 602 ditë pune shumën prej 1,204.00 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 602 ditë pune shumen prej 421.40 €, gjithsejtë shumen prej 1,625.40€. 4. Paditësit A. Z. në emër të shpenzimeve të ushqimit për 751 ditë pune shumën prej 1,502.00 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 751 ditë pune shumen prej 525.70 €, gjithsejtë shumen prej 2,027.70 €. 5. Paditëses M. D. në emër të shpenzimeve të ushqimit për 681 ditë pune shumën prej 1,362.00 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 681 ditë pune shumen prej 953.40 €, gjithsejtë shumen prej 2,315.40€. 6. H. S. në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune nga paga bazë 485.16 €, 50% t'ia paguaj shumen 242.58, dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për 744 ditë pune shumën prej 1,730.58 €. Me kamat ligjore 8 % nga dita e ushtrimit të padis deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. III. OBLIGOHET e paditura që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore për taksë në shumen prej 20.00 €, për përpilimin e padisë shumen prej 624.00 €, për një seancë shumën prej 811.20 € në shumë e përgjithshme 1,455.20 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. IV. DETYROHEN paditësit që paraprakisht të bëjnë pagesën e taksës gjyqësore shtesë në shumë prej 40.00 €, menjëherë pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. V. REFUZOHET kërkesa e përfaqësuesit të paditësit, për precizimin e kërkesëpadisë në shumen prej 264.00€, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, për shkaqe të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, kërkesëpadija e palëve paditëse të refuzohet e pa bazuar apo të ndryshohet aktgjykimi C.nr.36/20, i datës 07.07.2021.

I autorizuari i paditëseve, nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit së tyre, me datën 06.01.2020 kanë parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Agjencia për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur me seli në Prishtinë, në çështjen juridike-kontestimore për pagesën e ushqimit nga marrëdhënia e punës, udhëtimit, si dhe shpërblimit jubilar. Pala e paditur ka paraqitur përgjigje në padi, duke kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 07.07.2021 dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, pas dëgjimit të palëve në procedurë, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.36/20, të datës 22.07.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimin se paditësve i takon kompensimi i shpenzimeve të shpërblimit jubilar, rrugëtimit dhe ushqimit gjatë punës, duke u bazuar në: kontratat e punës në emër të B. B., B. B., G. B. K., A. Z. dhe M. D. dhe H. S. Vërtetimi në emër të B. B. lëshuar nga Qendra e Kompetencës Ferizaj, lista e pagës në emër të B. B., vërtetimi në emër të B. B. lëshuar nga Qendra e Kompetencës Ferizaj lista e pagës në emër të B. B., vërtetimi në emër të Gresa B. K. lëshuar nga Qendra e Kompetencës Ferizaj, lista e pagës në emër të G. B. K. ,vërtetimi në emër te A. Z. lëshuar nga Qendra e Kompetencës Ferizaj ,vërtetimi në emër te M. D. lëshuar nga Qendra e Kompetencës Ferizaj, vërtetimi në emër të H.S. lëshuar nga Qendra e Kompetencës Ferizaj, vërtetimi në emër H. S. numër prot.272/02 i datës 06.03.2014 të lëshuar nga shkolla e mesëm e bujqësisë Z. H. Ferizaj, lista e pagës në emër të H. S., certifikata e vendbanimit në emër të B. B. lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Ferizaj e datës 16.12.2019, certifikata e vendbanimit në emër të B. B. lëshuar nga zyra e gjendjes civile ne H.E. e datës 16.12.2019,certifikata e vendbanimit në emër te G. B. K. lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Shtime e datës 17.12.2019, ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile në emër të A. Z. lëshuar nga zyra e gjendjes civile, në fshati T. i M. e datës 04.01.2018 certifikata e vendbanimit në emër të M. D. lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Lipjan e datës 03.1.2020,lista e pagës në emër te A. Z.. kuponët fiskal lëshuar nga NI. Sh. T., vërtetimi në emër te B. B. lëshuar nga qendra e kompetencës Ferizaj, kuponët fiskal lëshuar nga NI. E. T., kuponët fiskal lëshuar nga Ntp. D. C., kuponët fiskal lëshuar nga Nt B.T., kuponët fiskal lëshuar nga Ntp. D.C. dhe Ntp. B. T., vërtetimi në emër të B. B. për ditët e pranisë në punë, vërtetimi në emër te B. B. për ditët e pranisë në pune. vërtetimi në emër të G. B. K. për ditët e pranisë në punë, vërtetimi në emër të A.Z. për ditët e pranisë në punë, vërtetimi në emër te M. D. për ditët e pranisë në punë, vërtetimi në emër të H.S. për ditët e pranisë në punë.

Më tej ka arsyetuar se është i pabazuar pretendimi i të paditurës se kërkesëpadija e paditësve duhet të refuzohet për faktin se nuk ekziston mundësia financiare sepse e paditura nuk ka pranuar ndihmë financiare nga Ministria e Financa për zbatimin e Kontratës Kolektive, për gjykatën është pretendim i pabazuar sepse e paditura është e obliguar drejtpërdrejtë që ta zbatojë këtë Kontratë Kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin dhe të siguroj mjete

financiare për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kontrata në fjalë, e jo të thirret se nuk ka mundësi financiare për të përmbushur obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimor të autorizuarit të palës së paditur se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin e aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ngase sipas vërtetimeve të lëshuara nga Qendra e Kompetencës në Ferizaj, janë vërtetuar ditët e kaluara në punë, po ashtu gjykata ka administruar edhe certifikatat e vendbanimit të paditëseve, për të vërtetuar vendbanimin në raport me nevojën për njohjen e shpenzimeve të udhëtimit. Ndërsa për paditësen H. S., gjykata e shkallës së parë ka administruar vërtetimin për sa i përket përvojës së punës. Së këndejmi nga provat që gjykata e shkallës së parë ka administruar, ka arritur që në mënyrë të drejtë të vërtetojë gjendjen faktike që korrespondon me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të ankimuar, në këtë mënyrë përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i pranueshëm edhe për Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe rrugëtimit në punë dhe shpërblimit jubilar dhe me të drejtë është bazuar në nenin 35 par. 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e nënshkruar me datë 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), e cila ka qenë e zbatueshme edhe në kohën kur është paraqit padia, duke i përmbushur kështu kushtet e kërkuara në bazë të dispozitës së lartcekur të KKAK-së. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e

vendosjes për kompensimin në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe shpërblimit jubilar, ka bërë gabim në aplikim të së drejtës materiale, ngase KKAK në nenin 35 par. 7, rregullon se *"Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore"*. Aplikimi i kësaj norme, është në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar për sa i përket ditëve të kaluara në punë të paditësit. Po ashtu për sa i përket shpërblimit jubilar, KKAK në nenin 35 par. 5.8 rregullon *"Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënsi i fundit në vlerë: për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë"*.

Lidhur me shumën e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitën e nenit 35, paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: *"...Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban"*, ndërsa paditësi deri në momentin e plotësimit të kushtit i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me këtë kontratë lidhur me kompensimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e është e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar vërtetohet. Kjo ngase nga provat e administruara gjegjësisht nga kuponët fiskal që kanë të bëjnë me pagesën e transportit, është vërtetuar lartësia, ndërsa nga certifikata e vendbanimit e drejta për të kërkuar këtë lloj të kompensimit.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar dhe për ushqime gjatë punës, të njëjtit janë legjitimuar që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësit e kanë rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën e nenit 450 të LPK-së dhe me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.6569/2021, me datë 23.05.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli